Procesi i vendimmarrjes në Këshill

Këshilli i komunës së Tearcës është organi më i lartë vendimmarrës në komunë të Tearcës. Kryetari i Këshillit zgjedhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit me propozim të Komisionit kandidues.

Kryetari i Këshillit kujdeset:

- ✓ për organizimin e punës së Këshillit;
- ✓ për zbatimin e Rregullores së Këshillit dhe jep sqarime në lidhje me zbatimin e saj;
- ✓ për sendërtimin e të drejtave të anëtarëve të Këshillit;
- ✓ për zbatimin e parimit për punë transparente të Këshillit, etj.

Kryetari i Këshillit i nënshkruan vendimet dhe aktet tjera juridike që i miraton Këshilli dhe më pas ia dorëzon Kryetarit të komunës për shpallje dhe proklamim. Votimi në Këshill mund të jetë i hapur dhe i fshehtë. Votimi i hapur në Këshill bëhet me ngritjen e dorës dhe me deklarim individual. Deklarimi individual mund të bëhet atëherë kur këtë do ta kërkojë një anëtarë i Këshillit me mbështetjen e 4 anëtarëve të tjerë. Votimi individual bëhet me deklarimin e çdo anëtari të thirrur të Këshillit "për" ose "kundër" propozimit ose me "përmbajtje" nga votimi.

Votimi i fshehtë në Këshill bëhet me fletëvotime ku secili fletëvotim duhet të jetë në të njëjtën madhësi dhe ngjyrë.

Organet e komunës së Tearcës gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sjellin akte të përgjithshme dhe akte të veçanta.

Me aktet e përgjithshme në mënyrë burimore rregullohen marrëdhëniet, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe personave juridik në suaza të kompetencave të komunës.

Organet e komunës së Tearcës sjellin edhe akte të veçanta kur vendosin në procedurë administrative ose kur bëhet zgjedhje apo emërim i personave, si dhe raste të parapara me ligj ose dispozitë tjetër.

Si akte të përgjithshme që sjell Këshilli i komunës së Tearcës janë: statuti, programet, planet, vendimet dhe dispozitat tjera juridike.

Procedura për miratimin e akteve të përgjithshme fillon me paraqitjen e propozimit për miratimin e aktit të përgjithshëm.

Propozimi për miratimin e aktit juridik duhet të përmbaj bazën juridike për miratim dhe shkaqet për të cilat duhet të miratohet.

Propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm nga kompetenca e Këshillit, e përcaktuar me Statutin e komunës, e japin Kryetari i komunës, organi drejtues, trupi punues i Këshillit ose shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet që i themelon Këshilli i komunës. Propozimi për miratimin e aktit të përgjithshëm mund t'i jepet Kryetarit të Këshillit në formë të shkruar ose gojarisht në seancë.

Propozimi për miratimin e aktit juridik i dorëzohet trupit punues përkatës ose organit kompetent në afat prej 3 ditë dhe më pas ky propozim i dorëzohet Kryetarit të komunës.

Këshilli i komunës e shqyrton propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm me qëndrimin e trupit punues ose organit drejtues dhe e përcakton arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit juridik. Nëse Këshilli vlerëson se nuk ka bazë dhe nevojë për miratimin e aktit juridik, për këtë e informon propozuesin.

Kur Këshilli i komunës së Tearcës do ta përcaktoj arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit të përgjithshëm, automatikisht cakton përpilues të aktit dhe nëse me propozimin për miratim është dorëzuar edhe propozimi i aktit juridik, Këshilli bën diskutim për miratimin e të njëjtit. Këshilli i komunës së Tearcës, programet, vendimet dhe aktet tjera juridike i miraton në procedurë të përcaktuar me ligj. Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve miratohen me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në raste të veçanta, Këshilli ndjek edhe procedurë urgjente për marrjen e vendimeve nëse kjo është e domosdoshme për të penguar fatkeqësitë elementare, rrethanat tjera të jashtëzakonshme ose kur është me interes të komunës.


Vendimet dhe aktet tjera juridike të Këshillit shpallen në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës". Vendimet dhe aktet tjera juridike të miratuara nga Këshilli i komunës hyjnë në fuqi ditën e tetë nga e dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës", nëse me Rregulloren e Këshillit dhe me Statutin e komunës nuk është përcaktuar ndryshe.


KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Emri dhe mbiemri	Pozita e të zgjedhurit	Vendbanimi
Besnik Osmani	Kryetar i Këshillit	f.Nerasht
Genc Misimi	Këshilltar	f.Sllatinë
Gjulten Qazimi	Këshilltare	f.Përshefc
Festim Elmazi	Këshilltar	f.Dobrosht
Erzen Elezi	Këshilltar	f.Gllogjë
Florenta Esati	Këshilltare	f. Gllogjë
Rijad Mustafi	Këshilltar	f.Neproshten
Arian Hakiki	Këshilltar	f.Nerasht
Gzim Azemi	Këshilltar	f.Dobrosht
Arjeta Shasivari	Këshilltare	f.Përshefc
Valon Idrizi	Këshilltar	f.Sllatinë
Imer Imeri	Këshilltar	f.Sllatinë
Sezgin Sherifi	Këshilltar	f.Tearcë
Amet Ziberi	Këshilltar	f.Odër
Rami Selmani	Këshilltar	f.Nerasht
Nesrine Qazimi	Këshilltare	f.Përshefc
Oliver Georgievski	Këshilltar	f.Tearcë
Ilço Tofillovski	Këshilltar	f.Tearcë
Metin Useini	Këshilltar	f.Tearcë

Këshillin e komunës së Tearcës e përbëjnë gjithsej 19 anëtarë. Në Këshill janë të përfshira 7 parti politike dhe koalicione. Anëtarët e Këshillit janë zgjedhur nga banorët e komunës së Tearcës në zgjedhje të drejtëpërdrejta me mandat katër vjeçar.

Këshilli harton dhe dikton politikën e komunës, miraton Buxhetin e komunës, llogarinë përfundimtare, miraton vendime, programe, raporte, rregullore si dhe akte tjera juridike.
Gjatë vitit 2023, Këshilli i komunës së Tearcës ka mbajtur gjithsejt 12 seanca të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.





AKTET E MIRATUARA NGA KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Nr.	Akti i miratuar	Data
1.	**Vendim** për përcaktimin e maksimumit të arkës për vitin 2023.	**26.01.2023**
2.	**Përfundim** për miratimin e Raportit vjetor për shfrytëzimin e mjeteve nga rezervat në Buxhetin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	**26.01.2023**
3.	**Vendim** për pagesë të mjeteve në vlerë mbi 50.000,00 denarë nga rezervat e parapara në Buxhetin e komunës së Tearcës për vitit 2023.	**26.01.2023**
4.	**Vendim** për përcaktimin e kriteriumit për shpërndarjen e mjeteve të bllok dotacionit për shpenzimet materiale të shkollave fillore të komunës së Tearcës.	**26.01.2023**
5.	**Vendim** për përcaktimin e së drejtës së shfrytëzimit të ndihmës financiare të njëhershme ose ndihmë në naturë për vitin 2023.	**26.01.2023**
6.	**Pëlqim** për realizimin e projektit Ndërtimi i rrugës lokale të fushës në vendbanimin Gllogjë.	**26.01.2023**
7.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2023.	**26.01.2023**
8.	**Përfundim** për miratimin e Planit strategjik për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Tearcës 2023-2027.	**26.01.2023**
9.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2023.	**28.02.2023**
10.	**Programë** për trajtimin human të qenve të pastrehë në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2023.	**28.02.2023**
11.	**Vendim** për përcaktimin e propozimit për themelimin e organit të përbashkët administrativ ndërkomunal për inspektim të mjedisit jetësor në rajonin planor të Pollogut.	**28.02.2023**
12.	**Vendim** për autorizimin e kryetarit të komunës së Tearcës që të nominoj inspektor të autorizuar në trupin e përbashkët administrativ ndërkomunal për mbikqyrje inspektuese në mjedisin jetësor në rajonin planor të Pollogut.	**28.02.2023**
13.	**Raport** për realizimin e Programës për ndriçim publik për vitin 2022.	**28.02.2023**
14.	**Plan Program** për ndërtim, rekonstruim dhe mirëmbajtje të ujësjellsave lokal për vitin 2023 me të cilat menaxhon NP Higjiena - Tearcë.	**28.02.2023**
15.	**Vendim** për ofrimin e ndihmës për të prekurit nga tërmeti katastrofik në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë.	**28.02.2023**
16.	**Konkluzion** për dhënien e Pëlqimit të Planit vjetor për punësime për vitin 2024 në SHFK “Faik Konica” f.Dobrosht.	**28.02.2023**
17.	**Përfundim** për miratimin e llogarisë përfundimtare të NP Higjijena-Tearcë për vitin 2022.	**28.02.2023**

Nr.	Akti i miratuar	Data
18.	**Vendim** për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të hapësirave në kuadër të objekteve në pronësi të komunës së Tearcës.	**28.02.2023**
19.	**Vendim** për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.232/2 dhe pjesë në PK nr.226 KK Neproshten.	**28.02.2023**
20.	**Vendim** për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.1716/2 KK Dobrosht.	**28.02.2023**
21.	**Vendim** për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.799 dhe pjesë në PK nr.808 KK Nerasht.	**28.02.2023**
22.	**Vendim** për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.504, PK nr.505 dhe PK nr.499 KK Neproshten.	**28.02.2023**
23.	**Vendim** për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.2263/1 KK Neproshten.	**28.02.2023**
24.	**Vendim** për përcaktimin e nevojës për miratimin e dokumentacionit për planifikim urbanistik për zgjerimin e hapësirës së planifikimit për PK nr.202 KK Nerasht.	**28.02.2023**
25.	**Vendim** për ndihmë të njëhershme financiare, nr.13-427/1	**28.02.2023**
26.	**Vendim** për miratimin e kërkesës së parashtruar nga grup qytetarësh f.Odër.	**28.02.2023**
27.	**Vendim** për ndihmë të njëhershme financiare, nr.13-428/1.	**28.02.2023**
28.	**Llogaria vjetore** e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	**15.03.2023**
29.	**Vendim** për rritjen e kompenzimit për pjesmarrje në seancë të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës.	**15.03.2023**
30.	**Vendim** për shkarkimin dhe zgjedhjen e kryetarit të Komisionit për planifikim dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.	**15.03.2023**
31.	**Vendim** për dhënie pëlqim Vendimit për miratimin e Llogarisë përfundimtare të NPP Rusino/Pollog për vitin 2022.	**28.04.2023**
32.	**Përfundim** për miratimin e Raportit tremujor për periudhën raportuese (kumulative) për tremujorin e parë nga 01.01.2023 deri 31.03.2023.	**28.04.2023**
33.	**Vendim** për miratimin e Llogarisë përfundimtare të Qendrës për zhvillim të rajonit planor të Pollogut (QZHRPP) për vitin 2022.	**28.04.2023**
34.	**Kalendari Buxhetor** për përgatitjen dhe miratimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2024.	**28.04.2023**
35.	**Vendim** për formimin e shoqatës për nxitjen e aktiviteteve inovative me prioritet në fushën e shkencës dhe teknologjisë iCARE Pollog.	**28.04.2023**

Nr.	Akti i miratuar	Data
36.	**Raport** për realizimin e Programit për punë të komunës së Tearcës për vitin 2022.	**28.04.2023**
37.	**Vendim** për formimin e Këshillit komunal për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në komunën e Tearcës.	**28.04.2023**
38.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2023.	**28.04.2023**
39.	**Vendim** për anulimin e Vendimit për rritjen e kompenzimit për pjesmarrje në seancë të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës, nr.13-535/1 nga 15.03.2023.	**28.04.2023**
40.	**Vendim** për përcaktim me prioritet në përgatitjen e dokumentacionit teknik për përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm-Ndërtimi i filter stacionit për f.Sllatinë dhe rezervoar për f.Neproshten-komuna e Tearcës.	**28.04.2023**
41.	**Vendim** për kofinancimin e projekteve nga Buxheti i komunës së Tearcës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm-Ndërtimi i filter stacionit për f.Sllatinë dhe rezervoar për f.Neproshten.	**28.04.2023**
42.	**Vendim** për ndarjen e mjeteve financiare.	**28.04.2023**
43.	**Vendim** për lirim nga pagesa e tatimit dhe taksave administrative.	**28.04.2023**
44.	**Programë** për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave në vitin 2023.	**30.05.2023**
45.	**Programë vjetore** për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në rajonin e komunës së Tearcës për vitin 2023.	**30.05.2023**
46.	**Vendim** për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në sipërfaqet publike në komunën e Tearcës.	**30.05.2023**
47.	**Raport** për dëmet e shkaktuara nga era e fuqishme më 04.02.2023.	**30.05.2023**
48.	**Raport** për realizimin e Programës vjetore për hapjen, rekonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	**30.05.2023**
49.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra nga klasa e I - IX me numër më të vogël se 20 nxënës në SHFK "Eqrem Çabej" f.Sllatinë për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
50.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHFK "Eqrem Çabej" f.Sllatinë nga klasa e I - V për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
51.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra nga klasa e I - IX me numër më të vogël se 20 nxënës në SHFK "Kiril Pejçinoviq" f.Tearcë për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
52.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHFK "Kiril Pejçinoviq" f.Tearcë nga klasa e parë (të re) dhe nga klasa e I - V për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
53.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra nga klasa e I - IX me numër më të vogël se 20 nxënës në SHFK "Asdreni" f.Gllogjë për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**

Nr.	Akti i miratuar	Data
54.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHFK "Asdreni" f.Gllogjë nga klasa e I - V për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
55.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra nga klasa e I - IX me numër më të vogël se 20 nxënës në SHFK "Faik Konica" f.Dobrosht për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
56.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHFK "Faik Konica" f.Dobrosht nga klasa e I - V për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
57.	**Vendim** për dhënie të Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra nga klasa e I - IX me numër më të vogël se 20 nxënës në SHFK "Ismail Qemali" f.Nerasht për vitin shkollor 2023/2024.	**30.06.2023**
58.	**Vendim** për ndarjen e mjeteve financiare për kuotën e anëtarësimit të Unionit të Bashkive dhe Komunave shqiptare në Rajon.	**30.06.2023**
59.	**Vendim** për konstatimin e pushimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të komunës së Tearcës Valmira Selimi.	**29.08.2023**
60.	**Përfundim** për miratimin e Raportit tremujor për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për tremujorin e dytë të vitit 2023.	**29.08.2023**
61.	**Rebalans** i Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2023.	**29.08.2023**
62.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2023.	**29.08.2023**
63.	**Vendim** për dhënie të pëlqimit të Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2024.	**29.08.2023**
64.	**Vendim** për dhënie të pëlqimit për mjetet e siguruara financiare për plotësimin e vendeve të punës sipas Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2024.	**29.08.2023**
65.	**Përfundim** për miratimin e Programit vjetor për punën e SHFK "Faik Konica" f.Dobrosht në vitin shkollor 2023/2024.	**29.08.2023**
66.	**Përfundim** për miratimin e Programit vjetor për punën e SHFK "Eqrem Çabej" f.Sllatinë në vitin shkollor 2023/2024.	**29.08.2023**
67.	**Përfundim** për miratimin e Programit vjetor për punën e SHFK "Kiril Pejçinoviq" f.Tearcë në vitin shkollor 2023/2024.	**29.08.2023**
68.	**Përfundim** për miratimin e Programit vjetor për punën e SHFK "Ismail Qemali" f.Nerasht në vitin shkollor 2023/2024.	**29.08.2023**
69.	**Përfundim** për miratimin e Programit vjetor për punën e SHFK "Asdreni" f.Gllogjë në vitin shkollor 2023/2024.	**29.08.2023**
70.	**Vendim** për vazhdimin e procedurës për përpilimin e planit urbanistik jashtë vendbanimit-vikend lagjja "Tre ujërat" f.Tearcë.	**29.08.2023**
71.	**Vendim** për ndarjen e ndihmës së njëhershme financiare.	**29.08.2023**
72.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e anëtarit të Komisionit për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime.	**28.09.2023**
73.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e anëtarit të Komisionit për arsim.	**28.09.2023**

Nr.	Akti i miratuar	Data
74.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e anëtarit të Komisionit për dhurata dhe mirënjohje.	**28.09.2023**
75.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e kryetarit të Komisionit për mundësi të njëjta mes grave dhe burrave.	**28.09.2023**
76.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e anëtarit të Komisionit për mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.	**28.09.2023**
77.	**Vendim** për shkarkimin e përfaqësuesit të Këshillit të komunës së Tearcës në Këshillin e Shkollës në shkollën fillore komunale "Asdreni" f.Gllogjë.	**31.10.2023**
78.	**Vendim** për emërimin e përfaqësuesit të Këshillit të komunës së Tearcës në Këshillin e Shkollës në shkollën fillore komunale "Asdreni" f.Gllogjë.	**31.10.2023**
79.	**Vendim** për shkarkimin e anëtarit të Këshillit drejtues të NP Higjiena-Tearcë.	**31.10.2023**
80.	**Vendim** për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për përpilimin e Programës për punën e Këshillit të komunës së Tearcës për vitin 2024.	**31.10.2023**
81.	**Vendim** për shkarkimin dhe emërimin e një anëtari të Këshillit për kryerjen e kontrollit të punës materialo-financiare të Ndërmarrjes së përbashkët publike Rusino/Pollog.	**31.10.2023**
82.	**Raport** tremujor (K1, K2 dhe K3) për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për tremujorin e tretë të vitit 2023.	**31.10.2023**
83.	**Plan operativ** për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës në kushte dimri për 2023/2024.	**31.10.2023**
84.	**Vendim** për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit "Jehona" f.Përshefc.	**31.10.2023**
85.	**Vendim** për ndarjen e mjeteve financiare për Forumin rinor f.Neproshten.	**31.10.2023**
86.	**Përfundim** për mosmiratimin e Vendimit për emërimin e anëtarit të Këshillit drejtues të NP Higjiena-Tearcë.	**31.10.2023**
87.	**Vendim** për verifikimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të komunës së Tearcës.	**15.11.2023**
88.	**Vendim** për ndryshimin e Vendimit për caktimin e këshilltarëve të autorizuar për lidhjen e martesave.	**15.11.2023**
89.	**Vendim** për emërimin e anëtarit të Këshillit drejtues të NP Higjiena-Tearcë.	**15.11.2023**
90.	**Rebalans** i Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2023.	**15.11.2023**
91.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2023.	**12.12.2023**
92.	**Vendim** për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për përpilimin e zgjidhjes ideoartistike të stemës së komunës së Tearcës dhe formimit të komisionit.	**12.12.2023**
93.	**Program** për punë e komunës së Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**
94.	**Program** për hapjen, rekonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**

KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Nr.	Akti i miratuar	Data
95.	**Program** për punën e Këshillit të komunës së Tearcës gjatë vitit 2024.	**12.12.2023**
96.	**Program** për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**
97.	**Program** për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e kulturës për vitin 2024.	**12.12.2023**
98.	**Program** për aktivitetet e komunës së Tearcës për përkrahjen e sektorit të OJQ në vitin 2024.	**12.12.2023**
99.	**Program** për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e sportit për vitin 2024.	**12.12.2023**
100.	**Program** për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**
101.	**Program** për mbrojtje sociale, mbrojtje të fëmijëve dhe kujdes shëndetësor për nevojat e qytetarëve të komunës së Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**
102.	**Program** për financimin e përpunimit të planeve urbanistike në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2024.	**12.12.2023**
103.	**Program** për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e zhvillimit ekonomik lokal (Zhel) për vitin 2024.	**12.12.2023**
104.	**Plan** për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidente tjera.	**12.12.2023**
105.	**Vlerësim** të rrezikut të rajonit të Tearcës nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet tjera.	**12.12.2023**
106.	**Vendim** për përcaktimin e lokacionit për vendqëndrim të përkohshme të transportit publik në f.Nerasht.	**12.12.2023**
107.	**Buxheti** i komunës së Tearcës për vitin 2024.	**20.12.2023**
108.	**Vendim** për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2024.	**20.12.2023**
109.	**Vendim** për përcaktimin e vlerës së pikëve për rrogat e nëpunësve shtetëror për vitin 2024.	**20.12.2023**
110.	**Vendim** për përcaktimin e kritereve për ndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për vitin 2024.	**20.12.2023**
111.	**Programë** për mbrojtjen e shëndetit të popullatës në vitin 2024.	**20.12.2023**
112.	**Programë** për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e mbrojtjes dhe shpëtimit, mbrojtjes nga zjaret dhe menaxhim me kriza për vitin 2024.	**20.12.2023**
113.	**Programë** për arsim dhe inspektimin e arsimit në komunën e Tearcës për vitin 2024.	**20.12.2023**
114.	**Vendim** për kompenzim financiar për anëtarin e Këshillit të komunës së Tearcës.	**20.12.2023**
115.	**Vendim** për caktimin e projekteve prioritare për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale në vitin 2024.	**20.12.2023**
116.	**Konkluzion** për tërheqjen e pikës 8 nga rendi i ditës.	**20.12.2023**

Janë miratuar edhe 11 Procesverbale të seancave të Këshillit të komunës. Të gjitha aktet juridike janë të shpallura në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës" dhe të njëjtat publikohen edhe në web faqen e komunës së Tearcës